



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

PAKR.nr.102/2020

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Have Haliti, kryetare, Tonka Berishaj (gjyqtare referuese) dhe Xhevdet Abazi, anëtarë, me zyrtaren ligjore Alba Makolli si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit V.B. për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së si dhe të akuzuarit U.Y. për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë si dhe përgjigjet në ankesë të mbrojtësve të akuzuarve V.B. av. N.R. dhe U.Y. av. H.S., të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.331/19 të dt. 10.01.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK, me datë 24.04.2020 mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.331/19 të dt. 10.01.2020, vërtetohet.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.331/19 të dt. 10.01.2020, të akuzuarin V.B. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse brenda afatit prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepër të re penale e nëse kryen vepër të re penale gjatë kohës së verifikimit atëherë në dënimin e shqiptuar do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt. 09.12.2019 deri me dt. 10.01.2020 si dhe dënim me gjobë në vlerë prej 500 (pesëqind) euro.

Të akuzuarin U.Y. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike apo analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në vlerë prej 1.000 (njëmijë) euro, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e qëndrimit në paraburgim nga dt. 09.12.2019 deri me dt. 10.01.2020, ashtu që një ditë burgimi llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë, në total në shumë prej 620 (gjashtëqindnjëzet) euro, ndërsa shuma e mbetur e dënimit me gjobë për pagesë është 380 euro.

Të akuzuarit V.B. dhe U.Y. janë obliguar që gjobat e lartshënuara ti paguajnë brenda afatit 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë, në të kundërtën gjykata do tua zëvendësojë secilit dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu siç u ka shqiptuar duke ua llogaritur një ditë burgimi me 20 euro gjobë.

Janë konfiskuar sasia prej 6.76 gram narkotik i llojit marihuanë si dhe paratë në vlerë prej 30 euro të konfiskuara përkohësisht nga akuzuari V.B. sipas vërtetimit mbi marrjen e përkohshëm të gjësendeve të dt. 09.12.2019 si dhe 2.36 gram narkotik të llojit marihuanë të konfiskuar përkohësisht nga i akuzuari U.Y. sipas vërtetimit mbi konfiskimin e përkohshëm të gjësendeve të dt. 09.12.2019 si objekt i veprës penale.

Janë obliguar të akuzuarit ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor secili do të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë për shkak të vendimit mbi sanksionin penal me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë sa i përket sanksionit penal ashtu që të akuzuarve tu shqiptojë dënim me burgim.

Përgjigje në ankesën e Prokurorit ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit V.B. av. N.R. me propozim që të refuzohet ankesa e cila është pa bazë ligjore të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar ngase është adekuat me rrethanat, mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe në përputhje me llojin dhe sasinë e narkotikëve të gjetur tek të akuzuarit.

Përgjigje në ankesën e Prokurorit ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit U.Y. av. H.S. me propozim që të refuzohet ankesa e prokurorisë si e pabazë dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Prokurori i Apelit me parashtresën PPA/I nr.106/20 të dt.24.02.2020, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarve tu shqiptohen dënime me burg efektiv, ndërsa të refuzohen përgjigjet në ankesa të mbrojtësve të të akuzuarve V.B. av. N.R. dhe U.Y. av. H.S. si të pabazuara.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, për shkak se kemi të bëjmë me aktgjykimin e ankimuar në të cilën të akuzuarit janë dënuar me kusht dhe gjobë, palët nuk janë njoftuar për seancën e kolegjit.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorisë dhe mbrojtësve të të akuzuarve, së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtën e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPPK-së dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kishin kushtëzuar prishjen e tij

Po ashtu gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, pasi që nuk lejohet ankesa për këtë bazë ankimore sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës dhe me këtë është pajtuar prokurori si dhe gjykata, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve tjera ankimore.

Vendimi mbi dënimin

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë. Në ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë thekson se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale si dhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, si dhe ligji është zbatuar në mënyrë të drejtë kur të akuzuarit janë shpallur fajtor, por se sanksioni penal nuk është i drejtë dhe i ligjshëm dhe dënimet janë të ulëta. Sipas ankesës gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar rrethanat lehtësuese por se nuk ka gjetur rrethana rënduese, përkundër se këto vepra janë bërë dukuri në Kosovë, se dëmtohet shëndeti i rinisë, pengohet arsimimi i mirëfilltë i tyre, të cilat gjykata nuk i ka vlerësuar. Prokuroria konsideron se dënimi i shqiptuar nuk është i mjaftueshëm ndërsa kryerësit e këtyre veprave penale vetëm do të stimulohen me dënime të tilla.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e matjes të dënimit, mori parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore ku si rrethana lehtësuese mori: pranimin e fajësisë si rrethanë posaçërisht lehtësuese, pranimin e singertë të fajësisë që nga faza e parë e procedurës penale, gjendjen jo të mirë ekonomike, faktin se më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, pendimin e shprehur për veprën e kryer, premtimin e dhënë se nuk do ta përsërisë veprën penale, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti.

Vlerësimin e këtyllë të rrethanave për matjen e dënimit, si të drejtë e aprovon edhe Gjykata e Apelit, e cila vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të saj dhe është në funksion të preventivës së përgjithshme, posaçërisht asaj të posaçme dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPRK-së. Për shqiptim të një dënimi më të lartë me burg efektiv siç propozon Prokuroria, nuk janë plotësuar kushtet ligjore, e aq më parë kur nuk theksohen rrethana të reja apo të atilla vendimtare të cilat do të arsyetonin dënim më të lartë.

Nga arsyet e cekura si më lartë ankesa u refuzua si e pa bazuar.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

**PAKR 102/20 datë 24.04.2020**

**Procesmbajtëse,**

**Alba Makolli**

---

**Anëtarët e kolegjit,**

**Tonka Berishaj**

---

**Kryetare e kolegjit,**

**Have Haliti**

---

**Xhevdet Abazi**

---